A.K.P.A.
Nr 2773 Prot.
Datë,më 13.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
QËNDRA FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr.971/2 prot **Tiranë me 15.10.2026**

Lënda: Njoftim për vend të lire pune

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",
QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lire të punës për pozicionin instruktor me kohë të pjesshme:

Instruktor/e për kursin Aftësi digjitale----------1 Person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme
Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për si vijon:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit
Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:
a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a. letërmotivimin për pozicioni:

b. jetëshkrimin (CV në);
c. kartën e identitetit;
d. diplomën;
e. librezën e punës;
f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm;
k. të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFPsë, brenda datës ..26.10.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.5.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

Drejtori

Valbona Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT - DREJTORIA E PËRGJITHSHME - NR.4 TIRANË - PUBLIK PROFESIONAL